FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 112

Tiranë – E mërkurë, 1 gusht 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 26.7.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", të ndryshuar.....	6857
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 26.7.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 319, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për reformën në administratën publike 2015–2020".....	6860
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 26.7.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", të ndryshuar.....	6873
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 26.7.2018	Për emërimin në detyrë të një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	6873
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.7.2018	Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.....	6874
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit", në fshatin Zenisht, Bashkia Mat.....	6875

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve "Rikonstruksion i rrugës Voskopojë–Shën Prodhom" dhe "Parku japonez dhe kopshtet e komunitetit", Bashkia Korçë.....	6877
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Zgjerim i hapësirës së varrezave në fshatin Shënepremte", Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.....	6879
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 454, datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim-asfaltim i unazës së qytetit, faza I", Bashkia Maliq.....	6880
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 455, datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim dhe asfaltim brenda lagjes 'Isa Boletini', faza IV", Bashkia Vlorë.....	6881
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugëve 'Naftëtari', 'Kristaq Lacka' dhe 'Qemal Stafa"', Bashkia Kuçovë.....	6882
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim-asfaltim i rrugës 'Belul Berisha"', në Bashkinë Elbasan.....	6883
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 26.7.2018	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, të pronës me emërtimin "Posta e Policisë Roskovec" dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar.....	6885
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 461, datë 26.7.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 22.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e ish-Shkollës së Ulët të Ndërtimit (3 kate) dhe ish-konviktit (4 kate), Shkozet, Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi"	6886
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 26.7.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 60, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore", të ndryshuar.....	6886
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 464 , datë 26.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës"	6888
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 26.7.2018	Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre.....	6891
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 26.7.2018	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Tizjana Gjergji.....	6892

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 26.7.2018	Për zgjerimin e sipërfaqes së Parkut Kombëtar "Mali i Tomorit".....	6893
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 26.7.2018	Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë–Verjon "Peizazh i mbrojtur".....	6900
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 26.7.2018	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën.....	6919
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 26.7.2018	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e qendrave kulturore për diasporën.....	6920
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 25, datë 25.7.2018	Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor.....	6922
	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokol Korro.....	6925

VENDIM
Nr. 446, datë 26.7.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1/1 shtohet emërtesa "Instituti i Statistikave".

b) Në pikën 1/2:

i. shtohet emërtesa "Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar";

ii. shfuqizohet emërtesa "Instituti i Statistikave".

c) Në shkronjën "a", të pikës 1/3, emërtesa "Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve" zëvendësohet me emërtesën "Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve".

ç) Në shkronjën "b", të pikës 1/3 dhe kudo në vendim, emërtesa "Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave" zëvendësohet me emërtesën "Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit".

d) Në lidhjen nr. 5, që përmendet në pikën 8, emërtesa "Koordinator në Institutin e Statistikave (INSTAT)", shfuqizohet.

dh) Lidhja nr. 5/1, që përmendet në pikën 8/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

e) Pas pikës 8/8 shtohet pika 8/9, me këtë përmbajtje:

"8/9. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Drejtor ekzekutiv", në sekretariatin teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar", janë sipas lidhjes nr. 5/9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

ë) Në lidhjen nr. 6/3, që përmendet në pikën 9/3, në kolonën "Pozicioni", pas emërtesës "Drejtor drejtorie" shtohet emërtesa "Koordinator – kategoria III-a".

f) Pika 9/6 ndryshohet si më poshtë vijon:

"9/6. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" (punonjësit civilë) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandën dhe Shtabin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, janë sipas lidhjes 6/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

g) Titulli i lidhjes 6/6, që përmendet në pikën 9/6, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" (punonjësit civilë) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandën dhe Shtabin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit".

gj) Pika 10/4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"10/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" (punonjës civilë) në Komandën dhe Shtabin e Forcës Tokësore,

Komandën dhe Shtabin e Forcës Detare, Komandën dhe Shtabin e Forcës Ajrore, Komandën dhe Shtabin e Komandës Mbështetëse, Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Qendrën e Personel-Rekrutimit, Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendrën e Stërvitjes Individuale në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendrën e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, si dhe për punonjësit civilë jomësimorë në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës, janë sipas lidhjes nr. 7/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

h) Titulli i lidhjes 7/4, që përmendet në pikën 10/4, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" (punonjës civilë) në Komandën dhe Shtabin e Forcës Tokësore, Komandën dhe Shtabin e Forcës Detare, Komandën dhe Shtabin e Forcës Ajrore, Komandën dhe Shtabin e Komandës Mbështetëse, Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Qendrën e Personel-Rekrutimit, Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendrën e Stërvitjes Individuale në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendrën e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, si dhe për punonjësit civilë jomësimorë në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës".

2. Përjashtimit për vitin 2018, nëpunësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit të institucioneve të administratës shtetërore, që do të transferohen në përbërje të strukturës dhe të organikës së AKSHI-t gjatë këtij viti, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën pagë mujore me atë që përfitonin përpara transferimit pranë AKSHI-t.

3. Për vitin 2019 e në vazhdim, nëpunësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit të institucioneve të administratës shtetërore, të cilët deri në momentin e transferimit në përbërje të strukturës dhe të organikës së AKSHI-t përfitonin një pagë më të lartë se paga sipas lidhjes 5/1 (përfshirë edhe nëpunësit e transferuar gjatë periudhës qershor–dhjetor 2018), do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën pagë mujore me atë që përfitonin përpara transferimit pranë AKSHI-t, deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies juridiko-financiare me këtë institucion.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2018:

a) Për INSTAT-in, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturën e Mbetjeve, të fillojnë nga momenti i transferimit të nëpunësve në pozicionet e reja pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse; dhe

b) Për sekretariatin teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, si dhe për përcaktimet në shkronjat "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "h", të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë pas hyrjes në fuqi të vendimit.

5. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore ku janë të punësuar nëpunësit/ punonjësit që do të transferohen gjatë vitit 2018 tek AKSHI-i ta njoftojnë këtë të fundit për kategorinë e pagës dhe pagesën aktuale të këtyre nëpunësve/punonjësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 5/1

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit	II-a	1	20.000
Zëvendëstitullar i institucionit. Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes	II-b	1	15.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse	II-b	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t, të atashuar pranë ministrive të linjës dhe të atashuar pranë institucioneve qendrore	III-a/1	1	20.000
Përgjegjës sektori në sektorët e atashuar pranë drejtorive rajonale të sistemit tatimor	III-b	1	15.000 5.000
Përgjegjës sektori të sektorëve të atashuar pranë institucioneve rajonale	IV-a	1	15.000 5.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
	III-b	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t, të atashuar pranë ministrive të linjës dhe të atashuar pranë institucioneve qendrore	III-b	1 ose 2	25.000
Specialist në sektorët e atashuar pranë degëve doganore	III-b	1 ose 2	15.000 5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes të atashuar pranë institucioneve rajonale/vendore	IV-b	1 ose 2, ose 3	15.000
	IV-c		5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse	IV-a IV-b	1 ose 2, ose 3	0

Për institucionet rajonale/vendore shtesën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekësh e përfitojnë vetëm nëpunësit e strukturave TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.

Lidhja nr. 5/9

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "drejtor ekzekutiv" në Sekretariatin Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Drejtor ekzekutiv	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-b	1
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	1 ose 2, ose 3

VENDIM
Nr. 447, datë 26.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 319, DATË 15.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015–2020"

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 319, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, emërtimi "ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike" zëvendësohet me "Zëvendëskryeministri".

2. Në dokumentin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Pas ndarjes "Financimi i strategjisë" shtohet ndarja "Vlerësimi i ri i kostos për planin e ri të aktiviteteve të strategjisë për periudhën 2018–2020", me përmbajtje sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Pas lidhjes nr. 1 shtohet lidhja nr. 1/1, "Plani i aktiviteteve dhe treguesit për periudhën 2018–2020", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pas lidhjes nr. 2 shtohet lidhja nr. 2/1, "Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike për planin e veprimit për periudhën 2018–2020", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Kudo në dokument:

- emërtimi "Agjencia Shqiptare për Ofrimin e Integruar të Shërbimeve" zëvendësohet me "Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara";

- shkurtesa "DPZHNH" zëvendësohet me "DZHM" dhe emërtimi "Departamenti i Programimit, Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj" zëvendësohet me "Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes";

- shkurtesa "MF" zëvendësohet me "MFE" dhe emërtimi "Ministria e Financave" zëvendësohet me "Ministria e Financave dhe Ekonomisë";

- shkurtesa "MIAP", emërtimi "Ministër/ri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike" dhe fjalët "ministri përgjegjës për administratën publike dhe inovacionin" zëvendësohen me emërtimin "Zëvendës-kryeministri";

- shkurtesa "MSHÇV" zëvendësohet me fjalët "ministri përgjegjës për çështjet vendore";

- shkurtesat "QKL" dhe "QKR" zëvendësohen me shkurtesën "QKB" dhe emërtimet "Qendra Kombëtare e Licencimit" dhe "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" zëvendësohen me emërtimin "Qendra Kombëtare e Biznesit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VLERËSIMI I RI
I KOSTOS PËR PLANIN E RI TË AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË, PËR PERIUDHËN 2018–2020

Përcaktimi i kostos së realizimit për planin e ri të aktiviteteve për periudhën 2018–2020 u realizua nëpërmjet procesit të vlerësimit të kostos potenciale të nevojshme nga secili institucion, i cili ka përgjegjësinë kryesore në realizimin e aktiviteteve të parashikuara, si dhe bazuar në vlerësimet aktuale të realizuara në kuadër të projekteve të ndryshme që po financojnë një sërë reformash në administratën publike. Duhet të theksohet këtu se kostimi i bërë në momentin e miratimit të SNRAP 2015–2020, për aktivitetet e periudhës 2018–2020, është përfshirë në kostimin e ri.

Fondet e vlerësuara të nevojshme për zbatimin e veprimeve të planit të ri të aktiviteteve të SNRAP-it për periudhën kohore 2018–2020, parashikohet të jenë në nivelin rreth 1.72 miliardë lekë ose rreth 13.23 milionë euro (për qëllime llogaritjeje është përdorur kursi i këmbimit EUR/ALL 1=130), të detajuara sipas lidhjes 2/1 "Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike për Planin e Veprimit për periudhën 2018–2020". Duhet të përmendim këtu që në kostimin e strategjisë nuk është përfshirë kostoja administrative (pagesa e nëpunësve, të cilët i kryejnë aktivitetet e tyre për shkak të detyrave të tyre funksionale), si dhe nuk janë kostuar 7 aktivitetet, të cilat lidhen me procedurat e thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e infrastrukturës TIK, për arsye se kjo varet nga proceset që paraprijnë këto aktivitete.

Tabela 4. Kostoja e financimit sipas fushave për periudhën 2018–2020

Fushat	Vlera (000 lekë)
Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit	143,463
Organizimi dhe funksionimi i administratës publike	1,293,799
Shërbimi civil: menaxhimi i burimeve njerëzore	86,931
Procedurat administrative dhe mbikëqyrja	195,960
TOTALI	1,720,154

Grafiku nr. 4. Pesha specifike e kostos sipas fushave të SNRAP-it



Siç vihet re, nga tabela 4 më sipër, peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për zbatimin e aktiviteteve në fushën e organizimit dhe funksionimit të administratës publike, të cilat janë investime në fushën kryesisht të inovacionit, ku peshën kryesore e zënë investimet për sistemin IPSIS dhe objektivat që lidhen me përmirësime të shërbimeve ndaj publikut me qëllim rritjen e eficiencës, transparencës dhe komunikimit me publikun, të cilat, në një masë të madhe, përfshijnë një reformë të thellë në drejtim të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

Shpenzimet për investimet në ICT zënë gati 72% të totalit të investimeve të nevojshme për zbatimin e reformës në administratën publike në vitet e ardhshme. Krahasuar me planin e kaluar 2015–2017, shpenzimet e trajnimit kanë pësuar një rritje në peshë specifike, nga rreth 4% në rreth 11% në planin e ri. Kjo rritje e peshës specifike vjen si rezultat i zbatimit të programit të shkëmbimit të eksperiencës së punonjësve të rinj të administratës publike, i cili financohet në masën 1 milion EUR.

Tabela 5. Zërat e shpenzimeve për periudhën 2018–2020

Zërat	Vlera (000 lekë)
Fond page	9,838
Shpenzime trajnimi	193,910
Ekspertizë	263,037
Investime ICT	1,234,997
Shpenzime të tjera dhe mirëmbajtjeje	18,370
TOTALI	**1,720,154**

Grafiku nr. 5. Pesha specifike e kostos sipas zërave të SNRAP-it



Duhet përmendur që niveli i boshllëkut financiar është shumë i ulët. Ai përllogaritet të jetë vetëm 4% (grafiku 6 më poshtë). Ky nivel mund të ulet më tej nëse një pjesë e aktiviteteve të planifikuara do të mbështeten nga OECD/SIGMA në fusha ku asistenca e kësaj të fundit ka qenë e rëndësishme për qeverinë, si: RIA, konsultimi publik etj.

Tabela 6. Burimet e financimit

	Vlera (000 lekë)
Buxheti i shtetit	905,932
EU (IPA)	290,021
Donatorë të tjerë	37,028
Banka Botërore	87,364
UNDP	332,594
Boshllëku Financiar	67,213

Grafiku 6. Pesha e specifike sipas burimeve të financimit



Në terma të fluksit të fondeve, siç jepet në tabelën 7, pjesa më e madhe e fondeve do të shpenzohen gjatë vitit 2018, dhe kjo lidhet me ecurinë e përfundimit të sistemit IPSIS dhe sistemeve të shërbimeve *online* të financuara nga projekti STAR 2 dhe Trust Fund i Bankës Botërore për sistemin IPSIS. Disa aktivitete të parashikuara për t'u zbatuar në vitin 2018 rezultojnë me boshllëk financiar.

Tabela 7. Fluksi i financimit/*cash flow* (000 lekë)

2018	2019	2020
906,087	**573,791**	**240,276**

Duke pasur një mungesë financimi dhe për kohën e mbetur të limituar për gjetjen e fondeve, këto fonde janë parashikuar në pjesën më të madhe të tyre në vitin 2019."

Plani i Aktiviteteve 2018-2020

Nr. Aktivitetit	Detajimi i aktivitetit	Nr. i nën-aktivitetit	Detajimi i nën-aktivitetit	Institucioni raportues/përgjegjës	Institucione të tjera përgjegjëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Mënyra e matjes së realizimit
Objektivi 1: Politikat planifikuese dhe koordinuese të përmirësuara për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete								
Aktiviteti 1.1	*Përmirësimi i procesit dhe cilësisë së hartimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike*	Nën - aktiviteti 1.1.1	Hartimi i metodologjisë për përgatitjen e dokumenteve strategjike (strategji, programe, plane veprimi, dokumente politikash etj).	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	TM IV 2018	TM IV 2019	Metodologjia e përgatitur
		Nën - aktiviteti 1.1.2	Hartimi i paketës ligjore për funksionalitetin e sistemit IPSIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit/ Grupi i Punës	TM IV 2018	TM IV 2019	Paketa e plotë rregullatore e hartuar dhe miratuar (1 VKM për IPSIS si e-regjister; 1 VKM për funksionalitetin e IPSIS; 2 Urdhra të KM për modulet e IPSIS në lidhje me përgatitjen e strategjive, planeve të veprimit, raportet e monitorimit, programet; IPS kalendar; Ndryshimet në Udhëzimet e përvitshme të PBA)
		Nën - aktiviteti 1.1.3	Funksionim i plotë i Sistemit të Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar - IPSIS ('go live' për IPSIS në 2019)	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Grupi i Punës	TM IV 2019	TM IV 2020	Raportet e monitorimit për performancën e sistemit
		Nën - aktiviteti 1.1.4	Përmirësimi i kapaciteteve të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & ministrive të linjës në drejtim të monitorimit të politikave/strategjive/planeve të veprimit/ programeve zhvillimore, në përputhje me metodologjitë e IPSIS & AFMIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike/Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Ministritë e linjës	TM IV 2018	TM IV 2020	Nr. i stafeve për politikat në ministritë e linjës i trajnuar
Aktivitet 1.2	*Përmirësimi i instrumenteve për politikat e zhvillimit dhe mirëqeverisjes në nivel qendror dhe në nivel sektori*	Nën- aktiviteti 1.2.1	Përgatitja e një Udhërrëfyesi për Objektivat e Zhvillimit te Mijëvjeçarit (fazë parapake si pjesë e procesit të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare përtej 2020)	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Grupi i Punës	TM III 2018	TM III 2019	Udhërrëfyesi i përgatitur dhe miratuar
		Nën- aktiviteti 1.2.2	Rishikimi i bazës ligjore dhe kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG-ve dhe/ose SWG për të adresuar sfidat në strukturat e qeverisë dhe ndryshimin e funksioneve	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	TM II 2018	TM IV 2018	Dokumente të rishikuara
		Nën - aktiviteti 1.2.3	Përgatitja e formateve standarde (tool kit) për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen & udhëzime operacionale/ Progresi IPMG (rishikimi i kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen)	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme/Ministria e Financave dhe Ekonomisë & ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2018	Toolkit i përgatitur
		Nën - aktiviteti 1.2.4	Funksionimi sistematik i Grupit Tematik për Politikëbërjen si dhe ngritja e rrjetit për politikëbërjen me njësitë e politikave në ministritë e linjës	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme/Ministria e Financave dhe Ekonomisë & ministritë e linjës	TM III 2018	TM I 2019	Nr. i mbledhjeve të G.T për Politikëbërjen Nr. i mbledhjeve për rrjetin e politikëbërjes me ML-të
Objektivi 2: Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis								
Aktivitet 2.1	*Përmirësimi i mekanizmave dhe instrumenteve të lidhura me konsultimin publik*	Nën- aktiviteti 2.1.1	Përgatitja e Udhëzimeve Operacionale për ministritë e linjës për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e e-regjistrit të konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM II 2018	TM IV 2018	Guida Operacionale e hartuar
		Nën - aktiviteti 2.1.2	Trajnim/ Ngritje kapacitetesh për stafin përgjegjës në ministritë e linjës për përdorimin e e-platformës së konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit / Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2018	Stafi i trajnuar
		Nën - aktiviteti 2.1.3	Përgatitja e manualit për konsultimin publik (për publikun dhe ekspertët) për të lehtësuar pjesëmarrjen në konsultimet publike përmes përdorimit të regjistrit të e-konsultimit	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM II 2018	TM IV 2018	Manuali i përdoruesve i hartuar
		Nën - aktiviteti 2.1.4	Publikimi në sistem i raporteve të konsoliduara që paraqesin nivelin e reflektimit të komenteve të publikut	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM II 2018	TM IV 2018	Funksionaliteti i platformës i përmirësuar
		Nën - aktiviteti 2.1.5	Monitorimi i rregullt i realizimit të procesit të konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2020	Raportet e monitorimit të hartuara (raporti i parë i përgatitur në TM I 2019)
Aktiviteti 2.2	*Zbatimi i procedurës për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator (vlerësimi ex-ante) gjatë procesit të hartimit të politikave/legjislacionit, bazuar në të dhëna dhe dëshmi*	Nën - aktiviteti 2.2.1	Vendosja e rregullave që bëjnë të detyrueshëm zbatimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM I 2018	TM II 2018	VKM 584 date 28.08.2003 me ndryshime e miratuar
		Nën - aktiviteti 2.2.2	Përditësimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit (RIA), në përputhje me nevojat dhe zhvillimet e mëtejshme të procesit	Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	TM I 2020	TM II 2020	Metodologjia e përditësuar
		Nën - aktiviteti 2.2.3	Forcimi i kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të nëpunësve (Rrjeti RIA) në ministritë e linjës dhe Kryeministri, me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator	Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM I 2018	TM I 2019	Numri i nëpunësve të trajnuar
		Nën - aktiviteti 2.2.4	Aplikimi i Vlerësimit të Ndikimit (RIA) për aktet ligjore të rëndësishme që hartohen nga ministritë e linjës	Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore	Ministritë e linjës	TM III 2018	TM IV 2018 30% e projekt-ligjeve shoqërohen me RIA	Nr. i projektligjeve të përzgjedhura që i nënshtrohen RIA-s
		Nën - aktiviteti 2.2.5	Përcaktimi i kritereve të kontrollit të cilësisë së RIA-s	Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	TM I 2019	TM II 2019	Kriteret e përcaktuara
Aktiviteti 2.3	*Rritja e transparencës në botimin e legjislacionit*	Nën-aktiviteti 2.3.1	Monitorimi i vazhdueshëm i botimit të akteve ligjore të konsoliduara, në faqet e internetit të institucioneve	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM I (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Raporte 6 mujore mbi gjetjet e monitorimit të publikimit të akteve
Aktiviteti 2.4	*Forcimi i masave për planifikimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP), me synim harmonizimin me PKIE dhe zvogëlimin e numrit të projektligjeve të paraqitura në Kuvend jashtë këtij programi*	Nën-aktiviteti 2.4.1	Përmirësimi i procesit të planifikimit të hartimit të akteve ligjore nëpërmjet përcaktimit të afateve dhe rregullave të përgjithshme të procesit të hartimit të PPAP	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Ministritë e Linjës	TM III (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Procedurat e reja të miratuara
		Nën-aktiviteti 2.4.2	Dërgimi sistematik në Parlament i planit analitik të akteve brenda muajit dhjetor të çdo viti	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM IV (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Plani përcjellë Parlamentit
		Nën-aktiviteti 2.4.3	Monitorimi sistematik i zbatimit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM I (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Raportet 4-mujore të monitorimit të hartuara
Objektivi 3: Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanës dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi.								
Aktiviteti 3.1	*Përmirësimi i mekanizmave për monitorimin e kuadrit strategjik dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020*	Nën-aktiviteti 3.1.1	Monitorimi sistematik i zbatimit të Planit Vjetor të hartimit të Dokumenteve Strategjike	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministritë e linjës	TM I 2018	TM IV 2019	(i) Plani Vjetor i Kuadrit Strategjik i hartuar; (ii) Raporti i Monitorimit i hartuar
		Nën-aktiviteti 3.1.2	Vendosja e një procesi sistematik për monitorimin e dokumenteve strategjike përmes moduleve IPSIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM I 2020	TM II 2020	(i) Urdhri për monitorimin e kuadrit strategjik, si pjesë e paketës ligjore për funksionimin e IPSIS (ii) Nr. i dokumenteve strategjike që hartohen në përputhje me metodologjinë e re
		Nën-aktiviteti 3.1.3	Përgatitja e Manualit të Trajnimit për stafet e ministrive të linjës në lidhje me monitorimin e kuadrit strategjik (strategji/programe/dokumente politikash) dhe trajnimi i stafit	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM IV 2018	TM II 2019	Manuali i përgatitur/ nr. i personave të trajnuar
Objektivi 4: Fuqizimi i strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.								
Aktiviteti 4.1	*Rishikimi funksional dhe i organizimit të brendshëm në institucionet e administratës shtetërore*	Nën-aktiviteti 4.1.1	Pilotimi i metodologjisë së SIGMA-s për ristrukturimin në 3 sisteme ministrore (institucionet e varësisë)	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM I 2019	(i) Pilotimi i përfunduar; (ii) Raportet e vlerësimit të hartuara
		Nën-aktiviteti 4.1.2	Vënia në zbatim e modelit të ri të organizimit për institucionet e varësisë në 3 sistemet e pilotuara	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM I 2019	(i) Strukturat e reja të krijuara; (ii) VKM të miratuara
		Nën-aktiviteti 4.1.3	Përkufizimi i tipologjisë standarde të organizimit të institucioneve të varësisë dhe miratimi ligjor i tyre	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM IV 2018	TM II 2019	Modeli i tipologjisë i miratuar. Miratimi i shoqëruar me ndryshime ligjore
Aktiviteti 4.2	*Mbështetje për funksionimin e NjQV-ve dhe forcim të kapaciteteve zbatuese*	Nën-aktiviteti 4.2.1	Publikimi i udhëzimeve për menaxhimin e burimeve njerëzore mbi politikat dhe praktikat në nivel lokal	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Departamenti i Administratës Publike	TM I 2018	TM II 2018	Udhëzime të publikura
		Nën-aktiviteti 4.2.2	Adoptimi i formateve standarde për përshkrimin e punës, procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të performancës bazuar në Toolkit për menaxhimin e burimeve njerëzore	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Departamenti i Administratës Publike	TM I 2018	TM II 2018	Formatet standarde të hartuara
		Nën-aktiviteti 4.2.3	Zbatimi i procesit të arkivimit fizik të dokumentacionit në secilën bashki	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	NJQV	TM III 2018	TM IV 2018	Numri i bashkive ku sistemi i arkivimit është funksional
		Nën-aktiviteti 4.2.4	Rritja e kapaciteteve institucionale për përfshirjen dhe konsultimin e publikut	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	NJQV/Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2018	(i) Numri i zyrtarëve të trajnuar mbi çështjet e përfshirjes dhe konsultimit publik; (ii) Numri i bashkive që aplikojnë sistemin e matjes së performacës mbi përfshirjen dhe konsultimin e publikut në vendimarrjen e qeverisjes vendore
Objektivi 5. Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike.								
Aktiviteti 5.1	*Ngritja e Qendrave të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike*	Nën-aktiviteti 5.1.1	Ngritja dhe funksionimi i së paku 9 Qendrave të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike në Tiranë dhe në rrethe	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2020	9 Qendra të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike në Tiranë dhe në rrethe, të ngritura dhe funksionale.
		Nën-aktiviteti 5.1.2	Ngritja dhe funksionimi i së paku 4 Njësive Lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike në zonat rurale	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2020	4 Njësi Lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike në zonat rurale.
		Nën-aktiviteti 5.2.1	Ndarja e sporteleve për 10 institucione qendrore	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2020	Numri i sporteleve të marra në administrim.

Aktiviteti 5.2	*Ndarja e Administrimit të Sporteleve të Shërbimit (front-office) për publikun nga zyrat përgjegjëse (back office) të shërbimit në institucionet qendrore*	Nën-aktiviteti 5.2.2	Shtimi i të paktën 60 sporteleve me standard të përmirësuar për ofrimin e shërbimeve publike në të gjitha Qendrat e Integruara ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2020	Numri i sporteleve të shtuara në të gjitha Qendrat e Integruara ADISA.
		Nën-aktiviteti 5.2.3	Përshtatja e procedurave të reja të brendshme dhe manualeve të institucioneve sipas standardeve të reja të punës	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2020	Numri i rregulloreve dhe manualeve të miratuara.
Aktiviteti 5.3	*Zhvillimi i kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike*	Nën-aktiviteti 5.3.1	Hartimi dhe miratimi i kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM I 2019	Akti nënligjor i miratuar
		Nën-aktiviteti 5.3.2	Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike pranë qendrave të integruara dhe sporteleve të shërbimeve ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2019	TM IV 2020	(i) Raporte periodike për vlerësimin e cilësisë; (ii) Lista e rekomandimeve të nxjerra
		Nën-aktiviteti 5.3.3	Pilotimi i zbatimit të kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike pranë institucioneve të qeverisjes qendrore	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2019	TM IV 2020	(i) Raporte periodike për vlerësimin e cilësisë; (ii) Lista e rekomandimeve të nxjerra
Aktiviteti 5.4	*Krijimi i "sporteleve me një ndalesë" për shërbimet administrative në nivel vendor*	Nën-aktiviteti 5.4.1	Pilotimi i sistemit online për ofrimin e shërbimeve administrative të bashkive (lidhja e sistemeve front office me back office duke ndërlidhur në një sistem të vetëm njësitë administrative me njësitë qendër)	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		TM I 2018	TM IV 2018	(i) Numri i bashkive që aplikojnë programin e ri të shërbimeve on-line të ofruara nga sportelet unike; (ii) Numri i shërbimeve të ofruara; (iii) Në 3 bashki (TM IV 2018) dhe shtrirja e tij në bashkitë e mbetura (roll-out TM IV 2019)
Aktiviteti 5.5	*Zhvillimi i kapaciteteve institucionale të ADISA-s dhe institucioneve qendrore për rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve*	Nën-aktiviteti 5.5.1	Trajnimi i stafit të administratës së brendshme (ADISA)	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2020	(i) Numri i punonjësve të trajnuar (ADISA); (ii) Numri i trajnimeve të zhvilluara.
		Nën-aktiviteti 5.5.2	Trajnimi i stafit të institucioneve qendrore	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2020	(i) Numri i punonjësve të trajnuar (institucione qendrore); (ii) Numri i trajnimeve të zhvilluara.
Objektivi 6: Rritja e kapaciteteve në fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil si dhe lehtësimi i procedurave në zbatim të tij.								
Aktiviteti 6.1	*Forcimi i kapaciteteve të DAP dhe strukturave të menaxhimit të burimeve njerëzore për të udhëhequr strategjikisht reformën e shërbimit civil*	Nën-aktiviteti 6.1.1	Përmirësimi dhe lehtësimi i komunikimit dhe ndërveprimit midis institucioneve publike dhe qytetarëve (krijimi i HUB-it për menaxhimin e burimeve)	Departamenti i Administratës Publike		TM II 2018	TM IV 2020	(i) Faza I: ndërtimi i strukturës/sistemit dhe pilotimi në institucionet kyç - ministri dhe disa institucione varësie deri në 100 përdorues (ii) Faza II: zgjerim në institucione dhe funksione- deri në 600 përdorues (Faza II fillon TM II 2019 dhe mbaron TM IV 2019 - zhvillimi; trajnimi TM I 2020- TM IV 2020). Hub i krijuar. Nëpunësit civilë të njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore të trajnuar për përdorimin e formateve të reja
		Nën-aktiviteti 6.1.2	Forcimi i kapaciteteve të nëpunësve në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të komisionit përzgjedhës për të përmirësuar më tepër procesin e rekrutimit	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM IV 2018	TM IV 2020	Nr. i personave të trajnuar
		Nën-aktiviteti 6.1.3	Rishikimi i përshkrimeve të punës dhe hartimi i katalogut të përshkrimeve të punës	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM III 2018	TM III 2019	Katalogu i hartuar
Aktiviteti 6.2	*Përmirësimi i procesit të rekrutimit nëpërmjet marrjes së opinionit të publikut mbi procedurat e rekrutimit*	Nën-aktiviteti 6.2.1	Kryerja e vlerësimeve 'ad-hoc' (sipas rasteve) për të marrë opinionin e aplikantëve mbi procesin e rekrutimit dhe marrja e masave për të adresuar çështjet që dalin nga vlerësimi	Departamenti i Administratës Publike		TM III 2018	TM IV 2020	(i) Vlerësimet e kryera; (ii) Gjetjet e reflektuara; (iii) Masat e marra për adresimin e tyre të evidentuara në raportet e brendshme të DAP
		Nën-aktiviteti 6.2.2	Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë për të përthithur studentët më të mirë në administratën publike (qendrore dhe vendore)	Departamenti i Administratës Publike	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore/NJQV	TM IV 2018	TM IV 2020	Panaire pune, marrëveshje bashkëpunimi, orë të hapura, etj.
Aktiviteti 6.3	*Shtrirja në shkallë të gjerë e Sistemit Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ/HRMIS) dhe vënia në funksionim e modulit të pagave*	Nën-aktiviteti 6.3.1	Zgjerimi i SIMBNJ në të gjitha institucionet e administratës publike	Departamenti i Administratës Publike	Institucionet e administratës publike	Në vijim	TM IV 2020	(i) 100% e institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil - TM IV 2018. (ii) 100% e institucioneve të administratës shtetërore, jo shërbim civil dhe institucionet e pavarura -TM II 2019; (iii) 100 % Bashkitë dhe qarqet- TM IV 2019;
		Nën-aktiviteti 6.3.2	Gjenerimi i pagave për punonjësit e administratës publike nëpërmjet SIMBNJ	Departamenti i Administratës Publike	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	TM II 2018	TM IV 2020	(i) 80% e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimti civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ- TM IV 2018; (ii) 100% e administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ- TM II 2019; (iii) të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore jo shërbim civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ brenda TM IV 2019; (iv) NJQV gjenerojnë pagat TM IV 2020
		Nën-aktiviteti 6.3.3	Trajnimi i nëpunësve të burimeve njerëzore dhe të njësive të financës për përdorimin e SIMBNJ	Departamenti i Administratës Publike	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Në vijim	TM IV 2021	Të paktën 200 punonjës të trajnuar çdo vit (burime njerëzore dhe financë)
Aktiviteti 6.4	*Rritja e nivelit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe aplikimi i unifikuar i tij në njësitë e qeverisjes vendore*	Nën-aktiviteti 6.4.1	Nxjerrja e udhëzimeve dhe rekomandimeve në lidhje me unifikimin e zbatimit të ligjit në shërbimin civil bazuar në problematikat e evidentuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në administratën publike	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil		TM II 2018	TM II 2019	(i) Udhëzime të nxjerra nga Komisioneri; (ii) Rekomandime të Komisionerit për rregullimin e situatave të paligjshme të zbatuara
		Nën-aktiviteti 6.4.2	Hartimi dhe propozimi për ndryshimet ligjore të domosdoshme për të unifikuar zbatimin e ligjit në administratën shtetërore dhe vendore	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil		TM II 2019	TM IV 2019	(i) Numri i udhëzimeve; (ii) Numri i ndryshimeve ligjore të propozuara
		Nën-aktiviteti 6.4.3	Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me ASPA-n për Njësitë e BNJ të pushtetit vendor, për të siguruar unifikimin e praktikave, në përputhje me detyrat dhe udhëzimet e Komisionerit	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2020	(i) Numri i kurseve të trajnimit të organizuara në bashkëpunim me ASPA-n; (ii) Numri i personave të trajnuar
Aktiviteti 6.5	*Ngritja e kapaciteteve të KMSHC për të mundësuar ushtrimin e plotë të mandatit të tij*	Nën-aktiviteti 6.5.1	Rishikimi dhe miratimi i strukturës së KMSHC dhe rritja e numrit të stafit	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	Këshilli i Ministrave/Kuvendi	TM II 2018	TM II 2019	(i) Struktura e miratuar; (ii) Nr i punonjësve shtesë
Aktiviteti 6.6	*Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të punonjësve të përfshirë në riinxhinierizimin e proceseve dhe në ofrimin e shërbimeve të përmirësuara për publikun*	Nën-aktiviteti 6.6.1	Trajnimi dhe ofrimi i asistencës 'online' për punonjësit e administratës publike, për gjenerimin e dokumenteve shoqëruese të disponueshme me vulë dixhitale në portalin e-albania, në emër të qytetarit dhe biznesit	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM I 2018	TM IV 2020 (e në vijim)	Nr. i punonjësve të trajnuar
Aktiviteti 6.7	*Forcimi i vazhdueshëm i ASPA si ofrues i trajnimeve për burimet njerëzore me synimin e përgatitjes dhe zhvillimit të një administrate publike eficiente*	Nën-aktiviteti 6.7.1	Zhvillimi i një sistemi efektiv për vlerësimin e trajnimit, që do të gjenerojë më shumë të dhëna lidhur me cilësinë e trajnimit, arritjen e objektivave dhe matjen e ndikimit të trajnimit në performancën individuale, të institucionit dhe të sistemit në tërësi	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	(i) Vlerësime objektive dhe të pavarura periodike të cilësisë çdo 2 vjet; (ii) të paktën 2 vlerësime të ndikimit të programeve të trajnimit çdo vit
		Nën-aktiviteti 6.7.2	Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me agjenci profesionale në fushën e kontrollit të cilësisë për edukimin/trajnimin me qëllim ngritjen e një sistemi për menaxhimin dhe vlerësimin e cilësisë së trajnimeve	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM II 2018	TM IV 2020	(i) Hulumtim i kryer; (ii) Anëtarësimi në dy rrjete ndërkombëtare
3. Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me/dhe me drejtimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, mbështet, koordinon dhe monitoron forcimin e kapaciteteve të bashkive për përmbushjen e kritereve dhe të standardeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian për funksionet e veta apo të deleguara të bashkisë dhe ka këto përgjegjësi:

a) Monitoron në mënyrë periodike përmbushjen e detyrimeve nga bashkitë, lidhur me ngritjen e strukturave të integrimit evropian dhe performancën në zbatimin e funksioneve të tyre, sipas përcaktimit të këtij vendimi;

b) Monitoron, mbështet dhe koordinon punën për zgjidhjen e problemeve të hasura, nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, me qëllim funksionimin e strukturës së integrimit evropian në çdo bashki;

c) Mbështet bashkinë në përcaktimin e fushave, prioriteteve dhe/ose çështjeve ku duhet të orientohet kërkesa e tyre për asistencën e Bashkimit Evropian;

ç) Bashkërendon me bashkitë procesin e vlerësimit kombëtar të performancës së tyre mbi

plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian;

d) Analizon zbatimin e masave për realizimin e agjendës së integrimit evropian në nivel vendor dhe ndikimin në lidhje me procesin e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

4. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mbikëqyr, jep orientim strategjik dhe informon mbi procesin e integrimit evropian dhe politikat e programet respektive, të cilat mund të zbatohen në nivel vendor dhe ka këto përgjegjësi:

a) Siguron pjesëmarrjen e përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore në forumet apo strukturat konsultuese për procesin e integrimit evropian dhe të asistencës së Bashkimit Evropian për këtë proces;

b) Bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, lidhur me asistencën dhe mbështetjen e bashkive në procesin e forcimit të kapaciteteve të tyre për procesin e integrimit evropian;

c) Informon mbi asistencën e Bashkimit Evropian për procesin e integrimit evropian, përfshirë programet nga të cilat përfitojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore;

ç) Informon bashkitë lidhur me hapjen e thirrjeve për propozime, në kuadër të programeve të ndryshme të financuara nga Bashkimi Evropian, nga të cilat përfitojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) Mundëson konsultimin e bashkive në lidhje me procesin e aplikimeve, duke shërbyer njëkohësisht si pikë lidhjeje e tyre me strukturat përkatëse të menaxhimit të programeve të financuara nga Bashkimi Evropian;

dh) Mbikëqyr kapacitetin dhe masën e përthithjes së asistencës së Bashkimit Evropian nga bashkitë.

5. Ministritë janë përgjegjëse për sigurimin e informacionit të nevojshëm për problemet sektoriale që lidhen me zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, sipas sektorëve që mbulojnë dhe në përputhje me funksionet e bashkive dhe kanë këto përgjegjësi:

a) Të caktojnë personin përgjegjës që do të shërbejë si pika kryesore e komunikimit me Ministrinë e Brendshme;

b) Të japin informacion për projektet e financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë për sektorin që mbulojnë, ku përfitues është bashkia;

c) Të analizojnë të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës së bashkive, lidhur me procesin e integrimit evropian, sipas sektorëve që mbulojnë.

6. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të ngrejë platformën elektronike intranet, të dedikuar për bashkitë, e cila do të shërbejë për ndarjen e praktikave më të mira, eksperiencave dhe informacionit mbi aktivitetet dhe çështjet e Bashkimit Evropian në bashki.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministritë e linjës dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 451, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E VARREZAVE PUBLIKE, SI DHE GARANTIMI I SHËRBIMIT PUBLIK TË VARRIMIT", NË FSHATIN ZENISHT, BASHKIA MAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ndërtimi, rehabilitimi dhe

mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit", në fshatin Zenisht, Bashkia Mat.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Mat.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "tokë truall", me sipërfaqe 10 100 m^2, me vlerë të përgjithshme 1 151 400 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 151 400 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Mat, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Mat.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Mat, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Mat.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Mat, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat dhe Bashkia Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PËR NDËRTIMIN, REHABILITIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE PUBLIKE, SI DHE GARANTIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK TË VARRIMIT", NË FSHATIN ZENISHT, BASHKIA MAT

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja truall/m^2	Çmimi/ lekë/m^2	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abaz Jakup Dobra	521/6	1319	10100	114	1 151 400	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI					**1 151 400**	

VENDIM
Nr. 452, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTEVE "RIKONSTRUKSION I RRUGËS VOSKOPOJË–SHËN PRODHOM" DHE "PARKU JAPONEZ DHE KOPSHTET E KOMUNITETIT", BASHKIA KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve "Rikonstruksion i rrugës Voskopojë–Shën Prodhom" dhe "Parku japonez dhe kopshtet e komunitetit", në Bashkinë e Korçës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë arë" dhe "tokë truall", me një vlerë të përgjithshme prej 1 831 945 (një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 831 945 (një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Korçë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Korçë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Korçë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronarët e pasurive së paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Korçë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS VOSKOPOJË–SHËN PRODHOM", BASHKIA KORÇË

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Zona kadastrale	I regjistruar pranë ZVRPP-së me nr.	Statusi i pronës sipas ZVRPP-së	Sipërfaqja e cila shpronësohet (m²)	Çmimi lekë/ m²	Vlera	Dokumenti i pronësisë
1	Bashkëpronarët Shkëmbi Cale	3819	1000/2	arë	31	100	3,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
2	Vrenos Mestan Shahinas	3819	994/2	arë	9	100	900	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
3	Donika Hasani, Përparim Hasani	3819	994/29	arë	24	100	2,400	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
4	Begator Mahmut Mukallari	3819	1003/1	arë	2	100	200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
5	Qemal Idriz Skënderi	3819	955/20	arë	12	100	1,200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
6	Jonuz Mersin Bezhani	3819	960/13	arë	400	100	40,000	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
7	Lefter Ilia Samara	3819	960/12	arë	165	100	16,500	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
8	Nastas Toli Grosi	3819	823/3	arë	11	100	1,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
9	Jani Thoma Bozda	3819	811/27	arë	21	100	2,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
10	Manastiri i Shën Prodhomit	3819	800	arë	53.4	100	5,340	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
11	Manastiri i Shën Prodhomit	3819	800/1	arë	632	100	63,200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
12	Gjergji Vasillaq Tërpo	3819	758/1	arë	15	100	1,500	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
13	Liljana Jorgji Tërpo	3819	759	arë	407	100	40,700	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
14	Edgar Stavro Frashëri	3819	954/9	arë	90	100	9,000	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
	TOTALI				**1872.4**		**187,240**	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
1	Astrit Sulejman Bebri	3819	823/1	truall	53	211	11,183	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
	TOTALI						**198,423**	

2. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE E PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PARKU JAPONEZ DHE KOPSHTET E KOMUNITETIT", BASHKIA KORÇË

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	ZK	Nr. i pas.	Statusi pronës sipas ZVRPP	Sip. e truallit që shpron. (m²)	Çmimi i truallit lekë/ m²	Vlera e truallit	Dokumenti i pronësisë
1	Naum Gogo, Gjergji Gogo	8562	3/616	Truall	180.4	9055	1,633,522	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
	TOTALI						**1 633 522**	

Shuma e përgjithshme për dy projektet është = 1 831 945

VENDIM
Nr. 453, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIM I HAPËSIRËS SË VARREZAVE NË FSHATIN SHËNEPREMTE", NJËSIA ADMINISTRATIVE TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Zgjerim i hapësirës së varrezave në fshatin Shënepremte", Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Divjakë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "tokë arë", me sipërfaqe 300 m^2, me vlerë të përgjithshme 109 200 (njëqind e nëntë mijë e dyqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 109 200 (njëqind e nëntë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Divjakë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Divjakë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Divjakë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohet për efekt shpronësimi pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Divjakë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Divjakë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Divjakë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Divjakë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Divjakë dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "ZGJERIM I HAPËSIRËS SË VARREZAVE NË FSHATIN SHËNEPREMTE", NJËSIA ADMINISTRATIVE TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja tokë arë/m^2	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Faslli Kasmi	473/1	3341	300	109,200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI				**109 200**	

VENDIM
Nr. 454, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM-ASFALTIM I UNAZËS SË QYTETIT, FAZA I", BASHKIA MALIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim-asfaltim i unazës së qytetit, faza I", Bashkia Maliq.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Maliq.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "truall", me sipërfaqe 350 m², me vlerë të përgjithshme 621 250 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 621 250 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Maliq, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Maliq.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Maliq, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronarët e pasurive së paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Maliq.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Maliq, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Maliq të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Maliq të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Maliq dhe Bashkia Maliq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "SISTEMIM-ASFALTIM I UNAZËS SË QYTETIT, FAZA I", BASHKIA MALIQ

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e truallit/m²	Çmimi i truallit/ lekë	Vlera e përgjithshme/ lekë	Lloji i dokumentit
1	Sanaber Agolli Liri Agolli Muhamare Agolli Repubilkë Agolli Leonart Agolli Arjan Agolli Alma Agolli	2573	1/206	200	1775	355 000	Vërtetim pronësie
2	Tahir Agolli Razije Agolli Vergjinush Agolli Zhaneta Agolli Shqiperie Agolli	2573	1/328	123	1775	218 325	Vërtetim pronësie
3	Pavllo Mentor Agolli Vergjina Agolli Dhimitri	2573	1/329	27	1775	47 925	Vërtetim pronësie
	TOTALI			**350**		**621 250**	

VENDIM
Nr. 455, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM DHE ASFALTIM BRENDA LAGJES 'ISA BOLETINI', FAZA IV", BASHKIA VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim dhe asfaltim brenda lagjes 'Isa Boletini', faza IV", Bashkia Vlorë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall", me sipërfaqe 16.5 m², dhe "ndërtim", me sipërfaqe 93.5 m², me vlerë të përgjithshme 3 766 884 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 766 884 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vlorë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Vlorë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Vlorë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronarët e pasurive së paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së

shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "SISTEMIM DHE ASFALTIM BRENDA LAGJES 'ISA BOLETINI', FAZA E IV", BASHKIA VLORË

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadas-trale	Nr. i pasurisë	Sip. e trua-llit	Çmimi i truallit/ lekë	Vlera e trua-llit	Sip. e ndërt/m²	Çmimi i ndërt./lekë	Vlera e ndërtim-it	Vlera e përgjith-shme /lekë	Lloji i dokumentit
1	Bashkëpronarët: Stefan Miho Morfo Miho	8602	3/30-T	16.5	10 903	179 900				179 900	Vërtetim pronësie
		8602	3/30-G				16.5	31 795	524 618	524 618	Vërtetim pronësie
		8605	3/12-ND				77	39 721	3 062 367	3 062 367	Vërtetim pronësie
	TOTALI									**3 766 884**	

VENDIM
Nr. 456, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËVE 'NAFTËTARI', 'KRISTAQ LACKA' DHE 'QEMAL STAFA'", BASHKIA KUÇOVË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugëve 'Naftëtari', 'Kristaq Lacka' dhe 'Qemal Stafa'", Bashkia Kuçovë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall", me sipërfaqe 532,3 m^2, "tokë arë", me sipërfaqe 67 m^2, dhe "ndërtesë", me sipërfaqe 279,61 m^2, me vlerë të përgjithshme 7 117 110 (shtatë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 117 110 (shtatë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Kuçovë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Kuçovë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Kuçovë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronarët e pasurive së paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpro-nësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Kuçovë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Kuçovë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në

hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë dhe Bashkia Kuçovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËVE 'NAFTËTARI', 'KRISTAQ LACKA' DHE 'QEMAL STAFA'", BASHKIA KUÇOVË

Nr.	Emri, mbiemri (pronari që shpronësohet)	Nr. i pasurisë	ZK	Sip. truall+ arë/m²	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sip. ndërtimi m²	Çmimi i ndërtesës lekë/m²	Vlera e ndërtesës lekë	Vlera totale	Shënime
1	Pëllumb Sina	11/668	2310	44	2,040	89760.0	59.61	32,317.00	1,618,190.00	1,707,950.0	Konfirmim ZVRPP
2	Murat Benja	6/314	2310	87	2,040	177480.0	126	32,317.00	1,993,623.00	2,171,103.0	Konfirmim ZVRPP
3	Celnik Braho	9/447	2310	48	2,040	97920.0	92	32,317.00	2,348,800.00	2,446,720.0	Konfirmim ZVRPP
4	Përparim Shkurti	11/53,11/577	2310	6	2,040	12240.0	2	32,317.00	49,768.00	62,008.0	Konfirmim ZVRPP
5	Luljeta Brahimi	1046/15	2918	67 (tokë arë)	311	20,837.0				20,837.0	Konfirmim ZVRPP
6	Dhimitër Bullari	9,/6	2310	228	2,040	465,120.0				465,120.0	Konfirmim ZVRPP
7	Sotiraq Bitri	11/235	2310	17	2,040	34,680.0				34,680.0	Konfirmim ZVRPP
8	Arjan Qato	6/196	2310	21	2,040	42,840.0				42,840.0	Konfirmim ZVRPP
9	Mihal Celaj	9,/7	2310	24	2,040	48,960.0				48,960.0	Konfirmim ZVRPP
10	QPN Kuçovë	9/462	2310	50	2,040	102,000.0				102,000.0	Konfirmim ZVRPP
11	Vangjel Pjetri	6/197	2310	7.3	2,040	14,892.0				14,892.0	Konfirmim ZVRPP
	Shuma që shpronësohet									**7,117,110.0**	

VENDIM
Nr. 457, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS 'BELUL BERISHA'", NË BASHKINË ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim-asfaltim i rrugës 'Belul Berisha'", në Bashkinë Elbasan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë

"ndërtesë", me sipërfaqe 17 m², dhe "truall", me sipërfaqe 50 m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 1 333 126 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 333 126 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Elbasan.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Elbasan.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Elbasan, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Elbasan.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË CILAT PREKEN NGA OBJEKTI: "SISTEMIM ASFALTIM I RRUGËS 'BELUL BERISHA'", ELBASAN

			Vërtetim pronësie				Truall			Banesa			Shpronësi-mi	
Nr.	**Familja që shpronësohet**	**Nr. i pasur.**	**m² truall banesë njësi**			**Shpron. m²**	**Çmimi shpron. lekë/m² lekë**		**Sip. banës. m² preket shpro.**		**Çmimi lekë/ m²**	**Shpron. lekë**	**Shuma lekë**	**Vërejtje**
1	Malvin Sefer Shuka	22/179	118,00	45.90	0,00	38.00	12764	485032.00	17.00	0.00	40878	694926.00	1179958.00	Konfir. ZVRPP
2	Zylyftar Shefqet Mujo	22/140	299,70	133.60	0,00	12.00	12764	153168.00	0.00	0.00	40878	0.00	153168.00	Konfir. ZVRPP
					0,00	**50.00**		**638200.00**				**694926.00**	**1333126.00**	

VENDIM
Nr. 459, datë 26.7.2018

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "POSTA E POLICISË ROSKOVEC" DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, shkronjës "k", të nenit 3, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të neneve 5, 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pronës me emërtimin "Posta e Policisë Roskovec", sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për realizimin e funksioneve me interes vendor.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryetari i Bashkisë Roskovec dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

INSTITUCIONI I PUSHTETIT QENDROR MRP (DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT FIER)
BASHKIA/KOMUNA ROSKOVEC
FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS: RUAJTJE RENDI

Nr. rend.	Zona kadas. indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m^2)	Nga sip. totale, sa ndërtesë m^2	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues Statusi juridik përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
										Ardhur me shkresën nr. 675/2, datë 22.7.2002
				Posta e Policisë Roskovec	576	138	Ruajtje rendi	MRP	Kom. i Policisë Fier	

VENDIM
Nr. 461, datë 26.7.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 22.12.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN E ISH-SHKOLLËS SË ULËT TË NDËRTIMIT (3 KATE) DHE ISH-KONVIKTIT (4 KATE), SHKOZET, DURRËS, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 1058, datë 22.12.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Procedurat e privatizimit të apartamenteve dhe lidhja e kontratës të bëhen brenda 1 (një) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Në rast se personi, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, nuk paraqitet pranë EKB-së të lidhë kontratën brenda afatit 1-vjeçar, familjes i humbet e drejta e privatizimit dhe objekti do të përdoret nga Enti Kombëtar i Banesave, në zbatim të politikave të strehimit, sipas legjislacionit në fuqi.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 463, datë 26.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 60, DATË 31.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2018 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 11, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 60, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 1 989 punonjës.".

b) Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit të përmendur në pikën 1 të tij, bëhet shtesa e mëposhtme:

"Në ndarjet "Gr. 6, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë"; "Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë"; "Gr. 11, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë"; "Gr. 13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale"; "Gr. 14, Ministria e Drejtësisë"; "Gr. 16, Ministria e Brendshme"; "Gr. 18, Shërbimi Informativ Shtetëror"; "Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare"; dhe "Gr. 88, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", shtohen nënndarjet përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar mbulohen nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2018, të njësive të qeverisjes qendrore.

Për punonjësit e kontraktuar për ALUIZNI-n, efektet financiare mbulohen nga të ardhurat e institucionit.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në këtë vendim të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA

Gr.	Emri i Institucionit	Numri punonjesve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
6	**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	**7**			
	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	7	Punonjës Arkivi	6 orë/ditë	6 muaj
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**	**10**			
	Drejtoria e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë	8	Specialistë	8 orë/ditë	6 muaj
	Dega e Thesarit Vlorë	1	Specialistë	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1	punonjës arkivi	8 orë/ditë	6 muaj
11	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**	**3**			
	Qendrat Rajonale Rinore Tiranë, Korçë dhe Vlorë	3	Sanitar	4 orë/ditë	6 muaj
13	**Ministria Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale**	**4**			
	Qendra Kombëtare Mirëmitjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve	4	Mjek	4 orë/ditë	6 Muaj
14	**Ministria e Drejtësisë**	**150**			
	ALUIZNI	140	Specialistë	8 orë/ditë	6 Muaj
	ALUIZNI	10	Teknikë të mesëm	8 orë/ditë	6 Muaj
16	**Ministria e Brendshme**	**2**			
	Prefektura Tiranë (Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë)	1	Arkivist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Prefektura Gjirokastër (Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë)	1	Arkivist	8 orë/ditë	6 Muaj
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**3**			
	SHISH (Degët Autonome Tropojë, Pogradec, Himarë)	3	Sanitar	4 orë/ditë	6 Muaj
87	**Institucione te tjera qeveritare**	**20**			
	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20	Specialistë	8 orë / ditë	6 Muaj
88	**Agjensia e Mbeshtetjes se Shoqerise Civile**	**1**			
	Agjensia e Mbeshtetjes se Shoqerise Civile	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	**200**			

VENDIM
Nr. 464 , datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "RRUGËT ZËVENDËSUESE M03 PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË MOGLICËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë "arë", "kultura bujqësore dhe drufrutorë", "objekte" dhe "truall", prej 4 780 005.5 (katër milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e pesë pikë pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë "tokë arë", "kultura bujqësore dhe drufrutorë", "objekte" dhe "truall", prej 4 780 005.5 (katër milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e pesë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga fondi i shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga fondi i shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmim ZVRPP", "Vërtetim hipotekar", "Certifikatë pronësie", të likuidohen për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E SHPRONËSIMIT, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA PROJEKTI "RRUGËT ZËVENDËSUESE M03 PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË MOGLICËS"

Nr.	Emri i pronarit	Zona kadastr.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja (m²)	Sipërfaqja, arë (m²)	Sipërfaqja, truall (m²)	Sipërfaqja, ndërtesë (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera e tokës arë (lekë)	Vlera e tokës, truall (lekë)	Vlera e ndërtesës (lekë)	Vlera e kulturave bujqësore (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Fshati Nikollare, Bashkia Maliq														
1	RAMAZAN BESIM VELIASI	2799	413/4	ARË	109	0	0	0	100	10900	0	0	11357.8	22,257.80	KONFIRMIM ZVRPP
2	FERIT RAIF HOXHALLARI	2799	510/2	ARË	277	0	0	0	100	27700	0	0	0	27,700.00	KONFIRMIM ZVRPP
3	SELIM ENVER BEQIRAJ	2799	593/4	ARË	306	0	0	0	100	30600	0	0	0	30,600.00	KONFIRMIM ZVRPP
4	SULO OSMAN SHKEMBI	2799	625/2	ARË	939	0	0	0	100	93900	0	0	0	93,900.00	KONFIRMIM ZVRPP
5	FUAT AVNI BEQIRAJ	2799	617/17	ARË +TRUALL	402	102	300	111	100	10200	59400	400000	64000	533,600.00	KONFIRMIM ZVRPP
6	ENVER MEHMET BEQIRAJ	2799	617/11	ARË +TRUALL	300	0	300	64	100	0	59400	280000	60000	399,400.00	KONFIRMIM ZVRPP
7	XHEMIL ENVER BEQIRAJ	2799	619	ARË +TRUALL	331	31	300	0	100	3100	59400	120000	99600	282,100.00	KONFIRMIM ZVRPP
8	FUAT AVNI BEQIRAJ	2799	622	ARË	990	0	0	0	100	99000	0	0	0	99,000.00	KONFIRMIM ZVRPP
9	PERPARIM LATIF SHKEMBI	2799	425/2	ARË	168	0	0	0	100	16800	0	0	17505.6	34,305.60	KONFIRMIM ZVRPP
10	VEZIRE EKUR VELIASI	2799	413/8	ARË	283	0	0	0	100	28300	0	0	29488.6	57,788.60	KONFIRMIM ZVRPP
11	LIVAN NYSTRET HOXHA	2799	510/3	ARË	239	0	0	0	100	23900	0	0	0	23,900.00	KONFIRMIM ZVRPP
12	SULO OSMAN SHKEMBI	2799	509/1	ARË	167	0	0	0	100	16700	0	0	0	16,700.00	KONFIRMIM ZVRPP
13	ALI BESIM VELIASI	2799	413/2	ARË	144	0	0	0	100	14400	0	0	15004.8	29,404.80	KONFIRMIM ZVRPP
14	TOSUN MITAT HOXHALLARI	2799	413/3	ARË	125	0	0	0	100	12500	0	0	13025	25,525.00	KONFIRMIM ZVRPP
15	LIVAN NYSTRET HOXHA	2799	413/5	ARË	92	0	0	0	100	9200	0	0	9586.4	18,786.40	KONFIRMIM ZVRPP
16	SANI MITAT HOXHALLARI	2799	413/6	ARË	131	0	0	0	100	13100	0	0	13650.2	26,750.20	KONFIRMIM ZVRPP
17	ENVER MEHMET BEQIRAJ	2799	413/7	ARË	137	0	0	0	100	13700	0	0	14275.4	27,975.40	KONFIRMIM ZVRPP
18	SEFEDIN ABAS VELIASI	2799	413/9	ARË	205	0	0	0	100	20500	0	0	21361	41,861.00	KONFIRMIM ZVRPP
19	SULO OSMAN SHKEMBI	2799	413/10	ARË	211	0	0	0	100	21100	0	0	21986.2	43,086.20	KONFIRMIM ZVRPP
20	FERIT RAIF HOXHALLARI	2799	425/4	ARË	74	0	0	0	100	7400	0	0	7710.8	15,110.80	KONFIRMIM ZVRPP
21	SEFEDIN ABAS VELIASI	2799	505/1	ARË	105	0	0	0	100	10500	0	0	0	10,500.00	KONFIRMIM ZVRPP
22	EKURAN NELKE VELIASI	2799	425/3	ARË	85	0	0	0	100	8500	0	0	8857	17,357.00	KONFIRMIM ZVRPP
23	XHEMIL ENVER BEQIRAJ	2799	425/5	ARË	63	0	0	0	100	6300	0	0	6564.6	12,864.60	KONFIRMIM ZVRPP
24	BEHAR BEJO HOXHA	2799	425/12	ARË	26	0	0	0	100	2600	0	0	2709.2	5,309.20	KONFIRMIM ZVRPP
25	DULE RRAPO XHEMOLLARI	2799	425/13	ARË	51	0	0	0	100	5100	0	0	5314.2	10,414.20	KONFIRMIM ZVRPP
26	PERPARIM LATIF SHKEMBI	2799	625/3	ARË	111	0	0	0	100	11100	0	0	0	11,100.00	KONFIRMIM ZVRPP
27	SANIE BEQIRAJ	2799	617/3	ARË	801	0	0	0	100	80100	0	0	0	80,100.00	KONFIRMIM ZVRPP
28	SELIM ENVER BEQIRAJ	2799	617/4	ARË +TRUALL	300	0	300	73	100	0	59400	100000	64000	223,400.00	KONFIRMIM ZVRPP
29	VAIT BARJAM HOXHALLARI	2799	610/2	ARË +TRUALL	933	633	300	82	100	78300	29700	0	89000	197,000.00	KONFIRMIM ZVRPP
30	TAIP MAHMUT XHEMOLLARI	2799	414/3	ARË	245	0	0	0	100	24500	0	0	0	24,500.00	KONFIRMIM ZVRPP
	Fshati Gurshqipe, Bashkia Maliq														
31	SELAM BESIM HOXHA	1911	349	ARË	85	0	0	0	100	8500	0	0	0	8,500.00	KONFIRMIM ZVRPP
32	TELO BILAL LLAZI	1911	351/2	ARË	358	0	0	0	100	35800	0	0	0	35,800.00	KONFIRMIM ZVRPP
630	396896.394	4591128.965		680	397540.214	4591983.681
631	396934.494	4591139.548		681	397566.673	4592021.781
632	396966.244	4591160.715		682	397588.898	4592046.123
633	396981.06	4591207.282		683	397609.006	4592056.706
634	396985.294	4591266.549		684	397626.998	4592072.581
635	397010.253	4591295.388		685	397657.689	4592088.456
636	397032.742	4591308.617		686	397707.431	4592119.148
637	397043.326	4591303.326		687	397730.715	4592135.023
638	397053.909	4591279.513		688	397753.998	4592142.431
639	397063.17	4591243.794		689	397783.631	4592139.256

640	397068.461	4591219.982		690	397804.798	4592136.081
641	397052.586	4591157.805		691	397822.363	4592133.952
642	397047.295	4591120.763		692	397839.723	4592131.848
643	397064.492	4591115.471		693	397859.832	4592135.023
644	397076.399	4591130.023		694	397894.757	4592148.781
645	397089.628	4591165.742		695	397928.623	4592208.048
646	397092.274	4591204.107		696	398003.765	4592286.365
647	397083.013	4591275.544		697	398049.009	4592320.761
648	397092.274	4591305.972		698	398015.142	4592324.994
649	397116.086	4591328.461		699	397960.109	4592344.044
650	397145.191	4591346.982		700	397911.425	4592356.744
701	397879.675	4592368.386		751	397282.106	4592930.208
702	397865.917	4592389.553		752	397271.787	4592969.896
703	397843.692	4592400.136		753	397263.056	4592981.008
704	397804.534	4592405.428		754	397238.449	4592981.008
705	397753.733	4592399.078		755	397209.874	4592978.627
706	397727.275	4592401.194		756	397187.649	4592978.627
707	397695.525	4592401.194		757	397166.218	4592983.39
708	397666.95	4592402.253		758	397163.837	4592996.883
709	397628.85	4592408.603		759	397155.105	4593018.315
710	397604.508	4592405.428		760	397148.755	4593025.458
711	397559	4592396.961		761	397144.787	4593033.396
712	397516.481	4592387.833		762	397139.23	4593042.127
713	397500.606	4592379.234		763	397132.087	4593052.446
714	397484.731	4592383.864		764	397124.149	4593061.177
715	397464.226	4592385.187		765	397109.862	4593065.146
716	397444.382	4592384.526		766	397097.162	4593064.352
717	397401.387	4592360.713		767	397084.462	4593048.477
718	397396.757	4592371.296		768	397071.762	4593038.158
719	397406.017	4592399.078		769	397054.299	4593041.333
720	397424.538	4592414.953		770	397039.218	4593039.746
721	397428.507	4592426.859		771	397023.343	4593027.84
722	397424.538	4592457.948		772	397010.643	4593017.521
723	397422.554	4592473.161		773	396994.768	4593000.852
724	397415.939	4592501.604		774	396979.686	4593000.852
725	397405.666	4592546.773		775	396951.905	4593006.408
726	397392.966	4592565.03		776	396934.685	4593008.339
727	397383.441	4592582.492		777	396925.16	4593017.07

728	397378.679	4592597.573		778	396913.254	4593021.832
729	397370.741	4592610.273		779	396878.329	4593019.451
730	397341.372	4592620.592		780	396855.31	4593010.72
731	397315.972	4592624.561		781	396840.229	4593002.782
732	397293.747	4592626.942		782	396820.385	4592992.464
733	397272.316	4592626.942		783	396796.572	4592985.32
734	397260.41	4592621.386		784	396774.347	4592974.207
735	397248.504	4592621.386		785	396748.153	4592948.807
736	397231.041	4592633.292		786	396717.197	4592928.17
737	397214.372	4592645.992		787	396692.591	4592928.964
738	397209.61	4592661.073		788	396671.953	4592949.601
739	397223.897	4592683.299		789	396648.934	4592951.189
740	397248.504	4592704.73		790	396621.153	4592947.22
741	397255.647	4592722.986		791	396581.466	4592959.92
742	397256.441	4592741.242		792	396525.903	4592987.701
743	397254.324	4592768.283		793	396501.297	4593013.101
744	397265.437	4592792.889		794	396475.897	4593036.12
745	397273.374	4592808.764		795	396455.259	4593059.933
746	397279.724	4592819.083		796	396430.653	4593078.983
747	397291.631	4592834.958		797	396398.903	4593091.683
748	397301.95	4592851.627		798	396353.659	4593106.764
749	397305.125	4592871.471		799	396315.757	4593121.448
750	397289.249	4592899.252		800	396301.47	4593138.911
801	396287.182	4593155.58		851	395727.124	4593835.312
802	396264.163	4593165.898		852	395733.077	4593830.351
803	396244.32	4593172.248		853	395764.497	4593795.625
804	396234.795	4593195.267		854	395778.718	4593786.364
805	396227.651	4593223.049		855	395802.2	4593785.041
806	396220.507	4593246.067		856	395823.036	4593790.664
807	396212.57	4593271.467		857	395839.903	4593797.609
808	396204.632	4593293.692		858	395854.455	4593800.255
809	396193.52	4593310.361		859	395869.007	4593801.908
810	396178.438	4593330.999		860	395882.237	4593803.893
811	396164.944	4593340.524		861	395892.489	4593808.854
812	396145.894	4593348.461		862	395914.317	4593801.048
813	396125.257	4593356.399		863	395941.305	4593804.223
814	396119.701	4593377.036		864	395964.324	4593813.749
815	396108.588	4593383.386		865	395970.674	4593831.211

816	396095.888	4593375.449		866	395974.643	4593852.642
817	396078.426	4593377.036		867	395974.643	4593879.63
818	396073.663	4593396.086		868	395982.58	4593905.824
819	396062.55	4593403.23		869	396000.043	4593924.08
820	396043.5	4593399.261		870	396015.918	4593942.336
821	396026.832	4593387.355		871	396026.236	4593962.18
822	396004.607	4593378.624		872	396041.185	4593986.786
823	395991.113	4593377.83		873	396046.477	4594001.338
824	395984.763	4593398.468		874	396034.571	4594017.214
825	395982.382	4593418.311		875	396030.602	4594042.349
826	395971.269	4593445.299		876	396035.894	4594074.099
827	395964.919	4593456.411		877	396037.217	4594103.203
828	395955.394	4593472.287		878	396033.248	4594132.307
829	395934.756	4593481.018		879	396029.279	4594164.058
830	395922.189	4593510.982		880	396022.664	4594203.745
831	395920.601	4593532.413		881	396022.664	4594243.433
832	395911.076	4593553.051		882	396031.925	4594279.152
833	395896.789	4593564.163		883	396047.8	4594302.964
834	395885.676	4593568.926		884	396072.935	4594329.422
835	395867.42	4593568.926		885	396107.331	4594395.568
836	395851.545	4593574.482		886	396119.238	4594432.61
837	395836.464	4593587.976		887	396139.544	4594501.253
838	395834.082	4593607.82		888	396150.128	4594553.112
839	395840.432	4593628.457		889	396163.886	4594585.92
840	395843.607	4593650.682		890	396224.705	4594615.872
841	395830.114	4593680.051		891	396716.831	4594980.997
842	395815.826	4593704.657		892	396822.665	4595097.414
843	395806.301	4593717.357		893	396822.665	4595139.748
844	395783.282	4593728.47		894	396827.957	4595200.602
845	395763.438	4593736.407		895	396857.061	4595253.519
846	395757.882	4593753.87		896	396925.853	4595277.331
847	395756.295	4593770.539		897	396965.54	4595330.248
848	395752.326	4593787.207		898	396989.353	4595401.686
849	395730.432	4593819.437		899	397007.874	4595507.519
850	395719.848	4593833.989		900	397023.749	4595565.728
901	397058.145	4595610.707		951	397832.837	4596909.958
902	397129.582	4595676.853		952	397841.833	4596922.129
903	397190.437	4595724.478		953	397848.183	4596933.242

904	397240.708	4595766.811		954	397857.708	4596941.179
905	397261.874	4595803.853		955	397873.583	4596950.175
906	397261.874	4595840.895		956	397894.22	4596957.584
907	397233.917	4595950.433		957	397914.858	4596971.342
908	397202.166	4596073.464		958	397935.496	4596987.746
909	397178.354	4596212.371		959	397958.25	4596997.8
910	397202.166	4596275.871		960	397977.3	4597009.442
911	397229.948	4596311.59		961	397994.762	4597014.346
912	397277.573	4596363.183		962	398011.696	4597015.933
913	397273.604	4596418.746		963	398030.217	4597014.875
914	397269.635	4596474.309		964	398047.679	4597010.112
915	397237.885	4596569.559		965	398065.671	4597011.7
916	397170.848	4596802.974		966	398082.075	4597019.637
917	397181.961	4596801.916		967	398094.246	4597027.575
918	397188.311	4596807.207		968	398104.829	4597037.1
919	397195.719	4596821.495		969	398114.883	4597046.096
920	397203.657	4596840.016		970	398125.996	4597049.271
921	397211.594	4596865.416		971	398146.104	4597049.271
922	397224.294	4596889.228		972	398155.1	4597051.387
923	397238.582	4596913.57		973	398170.446	4597056.679
924	397253.398	4596932.091		974	398186.85	4597061.971
925	397263.982	4596946.908		975	398202.196	4597061.971
926	397282.503	4596955.374		976	398215.954	4597058.796
927	397301.553	4596966.487		977	398244.53	4597033.396
928	397315.84	4596976.012		978	398260.484	4597018.561
929	397323.778	4596989.77		979	398270.009	4597006.258
930	397330.128	4597004.058		980	398279.534	4596995.543
931	397333.832	4597023.637		981	398290.25	4596989.986
932	397333.964	4597040.531		982	398304.537	4596987.605
933	397350.501	4597052.437		983	398312.078	4596985.224
934	397371.667	4597052.437		984	398325.968	4596979.271
935	397388.204	4597050.453		985	398340.653	4596971.73
936	397417.97	4597038.546		986	398351.765	4596962.205
937	397502.636	4597016.718		987	398364.069	4596957.046
938	397527.11	4597014.072		988	398380.737	4596954.267
939	397576.72	4597000.843		989	398413.678	4596945.536
940	397612.439	4596982.984		990	398425.981	4596940.774
941	397632.282	4596971.077		991	398434.316	4596935.217

942	397648.157	4596961.288		992	398440.269	4596920.93
943	397662.974	4596948.588		993	398450.191	4596901.483
944	397678.849	4596940.121		994	398461.7	4596891.164
945	397726.474	4596919.484		995	398478.766	4596887.592
946	397759.812	4596902.55		996	398496.493	4596886.115
947	397780.449	4596892.496		997	398512.698	4596879.831
948	397796.324	4596890.908		998	398528.574	4596860.98
949	397810.612	4596893.554		999	398544.779	4596843.12
950	397823.312	4596900.433		1000	398578.183	4596812.032
1001	398590.42	4596801.779		1051	398439.303	4596033.957
1002	398597.035	4596794.172		1052	398434.673	4596014.774
1003	398611.256	4596751.839		1053	398430.042	4596002.207
1004	398628.123	4596719.758		1054	398426.735	4595992.285
1005	398638.839	4596697.533		1055	398429.381	4595982.363
1006	398645.189	4596679.012		1056	398440.626	4595961.196
1007	398644.131	4596664.195		1057	398444.595	4595955.904
1008	398641.485	4596655.199		1058	398443.933	4595947.305
1009	398644.66	4596641.441		1059	398437.319	4595940.691
1010	398645.718	4596626.624		1060	398424.751	4595934.738
1011	398642.543	4596601.224		1061	398414.829	4595930.107
1012	398642.543	4596587.466		1062	398402.923	4595924.154
1013	398652.597	4596555.716		1063	398371.437	4595908.693
1014	398657.889	4596515.499		1064	398334.131	4595888.849
1015	398657.36	4596496.449		1065	398315.478	4595880.911
1016	398648.364	4596476.341		1066	398300.793	4595874.561
1017	398643.601	4596460.466		1067	398283.728	4595865.433
1018	398626.668	4596457.82		1068	398262.296	4595863.052
1019	398615.648	4596459.937		1069	398238.087	4595858.289
1020	398595.011	4596464.17		1070	398221.021	4595852.733
1021	398582.84	4596458.878		1071	398203.956	4595844.002
1022	398569.61	4596452.528		1072	398178.556	4595826.936
1023	398554.794	4596455.174		1073	398166.252	4595816.221
1024	398543.681	4596456.232		1074	398155.14	4595806.299
1025	398521.985	4596450.941		1075	398142.837	4595798.361
1026	398500.29	4596439.299		1076	398129.343	4595790.027
1027	398495.527	4596435.066		1077	398115.452	4595779.311
1028	398492.352	4596416.545		1078	398100.371	4595767.405
1029	398496.056	4596398.553		1079	398087.658	4595761.39

1030	398493.41	4596382.678		1080	398073.436	4595758.744
1031	398478.594	4596374.211		1081	398062.853	4595752.791
1032	398471.185	4596361.511		1082	398053.593	4595744.523
1033	398468.539	4596349.87		1083	398041.025	4595730.301
1034	398465.894	4596326.586		1084	398031.764	4595721.041
1035	398461.66	4596312.299		1085	398018.535	4595711.781
1036	398455.839	4596294.836		1086	397989.1	4595697.89
1037	398459.544	4596274.199		1087	397961.65	4595693.26
1038	398470.656	4596253.561		1088	397937.506	4595688.299
1039	398480.181	4596238.745		1089	397917.332	4595681.023
1040	398490.235	4596228.426		1090	397904.103	4595673.085
1041	398494.866	4596222.473		1091	397890.543	4595662.171
1042	398497.511	4596209.243		1092	397883.928	4595651.588
1043	398494.866	4596177.493		1093	397880.29	4595637.697
1044	398484.944	4596153.681		1094	397877.314	4595626.122
1045	398477.668	4596130.53		1095	397873.345	4595613.885
1046	398477.006	4596113.993		1096	397873.014	4595600.325
1047	398473.699	4596092.827		1097	397871.36	4595584.119
1048	398466.423	4596081.582		1098	397863.092	4595562.952
1049	398459.147	4596074.306		1099	397853.819	4595537.248
1050	398449.886	4596061.738		1100	397850.432	4595523.913
1101	397848.104	4595514.811		1151	397932.241	4594877.64
1102	397847.892	4595506.133		1152	397931.447	4594853.828
1103	397849.585	4595494.279		1153	397924.304	4594831.603
1104	397851.49	4595481.579		1154	397916.366	4594814.14
1105	397852.972	4595471.208		1155	397913.985	4594805.409
1106	397853.607	4595462.318		1156	397921.922	4594796.678
1107	397853.819	4595455.756		1157	397935.416	4594793.503
1108	397849.797	4595448.348		1158	397994.948	4594733.971
1109	397843.024	4595440.939		1159	398047.335	4594682.377
1110	397834.557	4595436.071		1160	398055.273	4594660.946
1111	397823.55	4595435.013		1161	398053.685	4594638.721
1112	397808.945	4595436.706		1162	398050.51	4594618.877
1113	397789.26	4595447.924		1163	398062.416	4594599.033
1114	397776.772	4595452.369		1164	398083.848	4594585.54
1115	397756.028	4595447.924		1165	398123.535	4594593.477
1116	397741.741	4595433.637		1166	398154.492	4594607.765
1117	397736.449	4595424.641		1167	398161.371	4594608.426

1118	397735.92	4595411.412		1168	398175.261	4594593.742
1119	397733.274	4595390.774		1169	398184.39	4594575.485
1120	397733.274	4595377.016		1170	398190.343	4594559.214
1121	397732.216	4595351.616		1171	398201.455	4594544.529
1122	397733.803	4595342.62		1172	398218.918	4594537.782
1123	397742.27	4595327.803		1173	398235.19	4594530.638
1124	397753.382	4595310.341		1174	398258.605	4594507.62
1125	397762.378	4595290.232		1175	398268.924	4594493.729
1126	397765.553	4595279.649		1176	398276.465	4594474.282
1127	397766.083	4595268.007		1177	398285.593	4594455.232
1128	397757.087	4595255.836		1178	398294.324	4594442.532
1129	397717.399	4595237.316		1179	398308.612	4594419.91
1130	397693.587	4595220.911		1180	398320.915	4594410.385
1131	397676.124	4595196.57		1181	398339.171	4594402.844
1132	397662.366	4595182.811		1182	398358.221	4594396.494
1133	397672.949	4595151.59		1183	398378.859	4594386.573
1134	397679.828	4595124.074		1184	398396.85	4594370.334
1135	397687.766	4595098.674		1185	398405.317	4594352.871
1136	397688.824	4595062.161		1186	398414.313	4594332.763
1137	397701.127	4595058.589		1187	398416.43	4594319.004
1138	397716.341	4595053.959		1188	398407.963	4594299.425
1139	397748.752	4595040.73		1189	398393.146	4594277.729
1140	397770.58	4595022.87		1190	398375.155	4594263.442
1141	397798.362	4594991.12		1191	398365.1	4594250.742
1142	397821.513	4594977.891		1192	398356.105	4594236.454
1143	397842.68	4594971.276		1193	398337.584	4594218.992
1144	397861.862	4594970.615		1194	398322.767	4594197.296
1145	397879.06	4594971.276		1195	398306.363	4594181.421
1146	397895.596	4594983.183		1196	398303.188	4594168.721
1147	397910.81	4594989.136		1197	398302.659	4594157.079
1148	397918.747	4594983.183		1198	398303.188	4594143.85
1149	397925.362	4594957.386		1199	398297.367	4594136.971
1150	397929.86	4594918.122		1200	398295.779	4594124.271
1201	398297.896	4594113.687				
1202	398305.437	4594096.225				
1203	398305.966	4594080.879				
1204	398301.203	4594061.829				
1205	398297.499	4594041.721				

1206	398299.087	4594020.554				
1207	398296.441	4594002.033				
1208	398299.616	4593987.216				
1209	398320.783	4593959.7				
1210	398347.241	4593937.475				
1211	398379.97	4593896.623				
1212	398427.595	4593874.133				
1213	398464.637	4593855.612				
1214	398514.908	4593819.893				
1215	398546.658	4593785.498				
1216	398578.408	4593751.102				
1217	398608.835	4593723.32				
1218	398635.293	4593694.216				
1219	398665.721	4593662.466				
1220	398696.148	4593636.008				
1221	398708.054	4593616.164				
1222	398734.512	4593589.706				
1223	398759.648	4593571.185				
1224	398778.169	4593532.82				
1225	398791.398	4593494.455				
1226	398800.658	4593456.091				
1227	398805.95	4593421.695				
1228	398821.825	4593385.976				
1229	398824.471	4593367.455				
1230	398852.402	4593355.383				
1231	398858.752	4593341.625				
1232	398872.511	4593325.75				
1233	398897.911	4593323.633				
1234	398920.136	4593334.216				
1235	398940.244	4593334.216				
1236	398963.528	4593322.575				
1237	398985.753	4593291.883				
1238	399042.903	4593184.991				

VENDIM
Nr. 469, datë 26.7.2018

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën (në vijim "QBD"), si person juridik publik buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për diasporën.

2. QBD-ja është përgjegjëse për:

a) Botimin, në përputhje me ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 35/2016, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", të teksteve që do t'i shërbejnë diasporës;

b) Redaktimin përfundimtar të teksteve që do të botohen;

c) Nxitjen e aksesit *online* të teksteve të veçanta për diasporën;

ç) Nxitjen e krijimit të formateve të posaçme për *e-book*;

d) Bashkërendimin e punës me operatorin ekonomik, i cili bën shpërndarjen e teksteve;

dh) Koordinimin me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për botimet për diasporën.

3. Shtypja e teksteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi realizohet nga vetë QBD-ja dhe shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit.

4. QBD-ja të përdorë programet e teksteve mësimore të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe botime të tjera me miratimin e ministrit përgjegjës për diasporën.

5. QBD-ja, me kërkesë të ministrit përgjegjës për arsimin dhe pas miratimit të ministrit përgjegjës për diasporën, boton edhe tekste të tjera nga ato të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi.

6. QBD-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e qendrës dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për diasporën. Ai emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën.

7. Nëpunësit dhe punonjësit e administratës së QBD-së emërohen e lirohen nga drejtori i QBD-së. Marrëdhënia e punës për drejtorin dhe punonjësit e QBD-së rregullohet me Kodin e Punës.

8. Pranë QBD-së funksionon Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ këshillimor e vendimmarrës për çështjet e botimeve për diasporën.

9. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është organ kolegjial, i përbërë nga pesë anëtarë, i cili ka përfaqësues nga:

- ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
- ministria përgjegjëse për arsimin;
- ministria përgjegjëse për diasporën.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë;
- Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

10. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka këto kompetenca:

a) Mbledh dhe shqyrton kërkesat vjetore për botime për diasporën dhe shqyrton kërkesat e herëpashershme, të cilat mund të mos jenë parashikuar në kërkesat vjetore;

b) Miraton programet e botimeve të QBD-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;

c) Planifikon shpërndarjen e teksteve të botuara nga qendra;

ç) Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

d) I propozon ministrit përgjegjës për diasporën botimin e teksteve të tjera;

dh) I propozon ministrit përgjegjës për diasporën çmimet e shitjeve të teksteve, të cilat vendosen duke respektuar dispozitat e ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, të ndryshuar, dhe kategoritë që përfitojnë falas kopje të teksteve të botuara nga QBD-ja, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky këshill ka dhe kompetenca të tjera, në përputhje me ligjin, të ngarkuara nga ministri përgjegjës për diasporën ose drejtori i qendrës.

11. Mandati i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

12. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën duhet të jenë drejtues të nivelit të lartë të institucioneve të përfaqësuara, të

cilët emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën, me propozim të titullarit të institucionit përkatës. Ministri përgjegjës për diasporën cakton njërin nga anëtarët si kryetar të këtij këshilli.

13. Kryetari dhe anëtari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën shkarkohen para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, kur:

a) Lirohet ose shkarkohet nga funksioni drejtues që ushtronte në institucionin që përfaqëson;

b) Me propozim të titullarit të institucionit të përfaqësuar, për shkak të ndryshimit të misionit e të detyrave që ai kryen në atë institucion;

c) Neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.

14. Ministri përgjegjës për diasporën, 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të mandatit 4-vjeçar ose menjëherë pas shkarkimit të anëtarit, i kërkon institucionit të përfaqësuar në Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën paraqitjen e emrit të kandidatit për anëtar të këtij këshilli.

15. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Botimeve të Diasporës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

16. Struktura dhe organika e QBD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

17. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QBD-së miratohen nga ministri përgjegjës për diasporën pas propozimit të drejtorit të saj.

18. QBD-ja është institucion buxhetor që financohet nga buxheti i shtetit.

19. Çmimet e shitjes së teksteve të botuara nga QBD-ja dhe kategoritë që mund t'i përfitojnë falas ato përcaktohen me vendim Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për diasporën dhe të ministrit përgjegjës për financën.

20. QBD-ja ka stemën dhe logon e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet "Republika e Shqipërisë", "Ministri i Shtetit për Diasporën", "Qendra e Botimeve për Diasporën", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë. Logoja e QBD-së të vendoset në çdo botim, në përputhje me nenin 26, të ligjit 16/2018, "Për diasporën".

21. Vula e QBD-së ka formën dhe elementet sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

22. Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ristrukturohet në Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD). Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

23. Vendimi nr. 843, datë 2.11.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM)", i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 470, datë 26.7.2018

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRAVE KULTURORE PËR DIASPORËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5 e 6, të nenit 6, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të vendimit nr. 58, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për qendrat kulturore në diasporë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e qendrave kulturore për diasporën (në vijim "QKD"), si persona juridikë, publikë, në varësi të kreut të misionit diplomatik të akreditуar në vendin pritës.

2. QKD-të e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin nr. 16/2018, "Për diasporën", dhe i raportojnë, mbikëqyren e koordinohen nga Agjencia Kombëtare për Diasporën (AKD).

3. QKD-të kanë si mision ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë.

4. QKD-të kryejnë këto funksione administrative:

a) Promovojnë Shqipërinë në ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë;

b) Nxisin dhe zhvillojnë njohuri për gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë;

c) Nxisin bashkëpunimin shkencor, teknik, teknologjik, sportiv e ekonomik, artistik dhe kulturor, ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës;

ç) Mbështesin dhe organizojnë rininë dhe grup-moshat e ndryshme të diasporës me aktivitete kulturore, edukative, sportive etj.;

d) Bashkëpunojnë me institucione të tjera për të zhvilluar aktivitetin e tyre brenda dhe jashtë vendit;

dh) Kryejnë detyra të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

5. QKD-të e ushtrojnë veprimtarinë në vendet me interes për diasporën, me qëllim mbartjen e trashëgimisë kulturore, të identitetit etj. dhe hapen me marrëveshje dypalëshe me shtetet e këtyre vendeve.

6. Struktura dhe organika e QKD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për diasporën.

7. QKD-të financohen nga buxheti i miratuar për përfaqësinë diplomatike.

8. Misionet diplomatike ku do të ushtrojnë aktivitetin e tyre QKD-të, funksionet që do të kryejnë, raportet me kreun e misionit, si edhe çështje të tjera të veprimtarisë së tyre rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të ministrit përgjegjës për diasporën.

9. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QKD-së miratohet me urdhër të kreut të misionit diplomatik, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të ministrit përgjegjës për diasporën.

10. QKD-ja drejtohet nga titullari, i cili administron dhe drejton veprimtarinë e përditshme të saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët. Për veprimtarinë e tij administrative ai përgjigjet para kreut të misionit diplomatik dhe ministrit përgjegjës për diasporën. Për çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike, titullari i QKD-së duhet të marrë mendimin e kreut të misionit.

11. Titullari i QKD-së emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën, në përputhje me pikën 2, të nenit 31, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

12. Titullari ushtron të gjitha kompetencat për drejtimin e veprimtarisë së institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me funksionet e objektivat e QKD-së, si më poshtë:

a) Drejton dhe përfaqëson QKD-në;

b) I raporton kreut të misionit diplomatik, ministrit përgjegjës për diasporën dhe drejtorit ekzekutiv të AKD-së;

c) Bashkërendon punën ndërmjet strukturave të qendrës dhe cakton detyra dhe objektiva përkatës për t'u realizuar nga këto struktura;

ç) Propozon programin vjetor të veprimtarive të QKD-së, të cilin ia paraqet për miratim kreut të misionit diplomatik dhe për dijeni ministrit përgjegjës për diasporën e drejtorit ekzekutiv të AKD-së;

d) Kontrollon mbarëvajtjen e aktivitetit të QKD-ve, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar dhe realizimin sa më të plotë të funksioneve të saj, si dhe merr masat e nevojshme për koordinimin sa më mirë të punës ndërmjet strukturave të QKD-së;

dh) Informon rregullisht dhe përgjigjet te kreu i misionit diplomatik, ministri përgjegjës për diasporën dhe drejtori ekzekutiv i AKD-së për mbarëvajtjen e aktivitetit të QKD-së dhe për realizimin e funksioneve të saj.

13. Titullarët e QKD-ve, të emëruar në misionet diplomatike, pajisen me pasaportë diplomatike dhe gëzojnë të njëjtin status me diplomatët gjatë periudhës që janë të emëruar në këto misione. Ata marrin gradë diplomatike, në varësi të strukturës së misionit diplomatik, dhe trajtohen financiarisht me pagën, shtesat mbi pagë dhe kompensimin për koston e jetesës sipas gradës së emërimit në misionin diplomatik në vendin ku shërbejnë.

14. Anëtarët e familjes së titullarëve pajisen me pasaporta diplomatike dhe gëzojnë të njëjtin trajtim me familjet e anëtarëve të diplomatëve, sipas ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm, të Republikës së Shqipërisë", dhe të akteve nënligjore në fuqi.

15. Nëpunësit e QKD-ve do të punojnë me kohë të plotë, por nuk do të jenë të akreditуar në shtetin pritës. Ata emërohen nga ministri përgjegjës për diasporën, me propozim të kreut të misionit diplomatik.

16. Vulat e QKD-ve kanë formën dhe elementet sipas përcaktimit të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare".

17. Stema e QKD-ve përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë", "Ambasada përkatëse", "Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme", si dhe "Qendra Kulturore për Diasporën", në përputhje me vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së republikës dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

18. Ngarkohen ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministri i Shtetit për Diasporën, Agjencia Kombëtare për Diasporën dhe Qendrat Kulturore për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 25, datë 25.7.2018

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 34, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU 1
BORDI I INSTITUCIONIT ARSIMOR DHE MISIONI I TIJ

1. Bordi i institucionit arsimor, publik dhe privat (në vijim "bordi"), është organ kolegjial që ka në përbërje të tij përfaqësues nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit, si dhe përfaqësues të komunitetit, të njësisë arsimore vendore dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Bordi ka si mision të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

3. Bordi e realizon misionin e tij nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët kryesorë brenda e jashtë institucionit arsimor, me njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe me njësinë arsimore vendore.

KREU 2
NGRITJA E BORDIT

1. Përgjegjësinë për ngritjen e bordit e ka përfaqësuesi i njësisë arsimore vendore (në vijim "përfaqësuesi").

2. Titullari i njësisë arsimore vendore siguron nga njësitë e vetëqeverisjes vendore listën e përfaqësuesve të tyre në bordet e institucioneve arsimore përkatëse.

3. Përfaqësuesi drejton mbledhjet e këshillit të mësuesve për zgjedhjen e mësuesit në bord dhe organizon përfshirjen në bord të pjesëtarëve të tjerë nga komuniteti.

KREU 3
PËRBËRJA E BORDIT

1. Bordi ka kryetarin dhe sekretarin e tij.

2. Bordi përbëhet nga përfaqësues të prindërve të nxënësve, nga përfaqësues të mësuesve, nga përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, nga nxënës, nga përfaqësues të komunitetit/komuniteteve (me ndikim në jetën komunitare, nga bota e biznesit, përfaqësues të OJF-ve, të interesuara për mbarëvajtjen e institucionit, të cilët nuk duhet të jenë prindër të nxënësve).

3. Në ngritjen e bordit u kushtohet kujdes i veçantë përfaqësimit gjinor, pakicave kombëtare dhe grupeve të tjera të veçanta.

4. Drejtori i institucionit arsimor nuk bën pjesë në bord.

5. Në institucionet arsimore, bordi përbëhet nga shtatë vetë: një mësues, dy prindër, dy nxënës, një pjesëtar tjetër i komunitetit dhe një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse. Kur në bord nuk ka nxënës, ai përbëhet nga një mësues, tre prindër, dy pjesëtarë të tjerë të komunitetit dhe një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

6. Prindërit zgjidhen me shumicë votash të fshehta nga këshilli i prindërve. Mësuesi zgjidhet me shumicë votash të fshehta nga këshilli i mësuesve. Nxënësit zgjidhen me shumicë votash nga qeveria e nxënësve. Pjesëtarët e tjerë të komunitetit përfshihen në bord me nismën e tyre dhe përzgjidhen me votim të fshehtë nga anëtarët e tjerë të bordit. Mandati i përfaqësuesve të prindërve, nxënësve dhe mësuesve është i vlefshëm kur shoqërohet me kopje të procesverbalit të organit që i ka përzgjedhur.

7. Përfaqësuesi në bord i njësisë së vetëqeverisjes vendore caktohet nga këshilli i saj.

8. Në bord bën pjesë, pa të drejtë vote, një përfaqësues i njësisë arsimore vendore ose një i deleguar i atij institucioni, i cili merr pjesë në mbledhjen e konstituimit të bordit.

9. Kryetari dhe anëtarët e bordit nuk duhet të kenë:

a) Lidhje familjare me drejtorin (bashkëshort/ bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit a bashkëshortes);

b) Precedentë penalë.

KREU 4
TË DREJTAT E BORDIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR

1. Bordi ka të drejtë:

a) T'i kërkojë drejtorit të institucionit t'i raportojë për kushtet e të nxënit, për arritjet e nxënësve dhe për aspekte të zbatimit të legjislacionit në institucion;

b) Të ftojë, për t'u kërkuar mendim, nëndrejtorët, mësuesit, kryetarin e këshillit të prindërve, kryetarin e qeverisë së nxënësve, ekspertë të arsimit dhe përfaqësues të OJF-ve;

c) T'u drejtohet me shkrim ose të takojë, përfaqësues të njësisë arsimore vendore dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e kushteve të të nxënit në institucion;

d) Të komunikojë drejtpërdrejt, në raste të veçanta, me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në lidhje me aspekte problematike të zhvillimit të veprimtarisë së institucionit arsimor;

e) Të ndërtojë dhe të forcojë një partneritet veprues "institucion arsimor-prindër-komunitet" me synim përmirësimin e mjedisit në shkollë;

f) Të nxisë ofrimin e shërbimeve dhe mbështetje për familjet në nevojë;

g) Të rrisë aftësitë e prindërve dhe rolin ndikues të tyre në edukimin e fëmijëve.

KREU 5
DETYRAT E BORDIT

1. Bordi ka për detyrë:

a) Të miratojë planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit;

b) Të miratojë planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni;

c) Të miratojë kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor;

d) Të marrë pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit;

e) Të shqyrtojë rregulloren e brendshme të institucionit;

f) Të miratojë hapjen dhe mbylljen e shërbimeve të institucionit për të tretët;

g) Të shqyrtojë raportin vjetor financiar të institucionit;

h) Të ndjekë përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit;

i) Të përfaqësojë shqetësimet e qytetarëve dhe të prindërve te drejtuesit dhe/ose administratorët e institucioneve arsimore për të përmbushur nevojat e nxënësve/fëmijëve;

j) Të përfaqësojë shqetësimet e institucionit arsimor te qytetarët, te tatimpaguesit dhe te prindërit në komunitet;

k) Të nxisë dhe të mbështesë zbatimin e nismave gjithëpërfshirëse në dobi të nxënësve/ fëmijëve dhe të komunitetit;

l) Të monitorojë e të vlerësojë institucionin arsimor, në mënyrë që bordi të mund të marrë vendime në vazhdim;

m) Të propozojë dhe të sjellë në vëmendje të drejtorisë së institucionit arsimor, të njësisë arsimore vendore dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore çështje që kanë të bëjnë me nevoja të identifikuara nga prindër, nxënës, mësues apo aktorë të tjerë të komunitetit.

2. Bordi përpiqet për të siguruar kontribute të ligjshme vendëse ose të huaja për mbarëvajtjen e institucionit.

3. Bordi realizon në tetor dhe në mars dy takime të përbashkëta me këshillin e prindërve të institucionit për veprimtarinë e tij.

4. Bordit u dërgon raportin e tij, në fund të vitit shkollor, këshillit të prindërve, qeverisë së nxënësve, njësisë arsimore vendore dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore.

KREU 6
FUNKSIONIMI I BORDIT

1. Bordi zgjidhet një herë në tre vjet dhe përsëritja e mandatit nuk është e kushtëzuar. Mandati i përfaqësuesit të njësisë së vetë-qeverisjes vendore bëhet një herë në katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Bordi mblidhet jo me pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.

3. Mbledhja e bordit, me përjashtim të mbledhjes së parë të krijimit të tij, e cila kërkon detyrimisht pjesëmarrjen e 3/5 të anëtarëve të tij, zhvillohet kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të bordit.

4. Bordi i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari.

5. Kryetari ose anëtari i bordit largohet nga bordi kur gjatë dy viteve të njëpasnjëshme, mungon në të paktën gjysmën e mbledhjeve të tij. Bordi, nëpërmjet sekretarit të tij, njofton me shkrim institucionin/organin përkatës për largimin e përfaqësuesit të tij nga bordi. Zëvendësimi i përfaqësuesit kryhet nga të njëjtat organe/institucione brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, sipas procedurave të përshkruara në këtë udhëzim.

KREU 7
KRYETARI I BORDIT

1. Si rregull, bordi të drejtohet nga një prind, i cili do të jetë kryetari i bordit.

2. Kryetari i bordit nuk është mësues.

3. Kryetari i bordit:

a) Zgjidhet në mbledhjen e parë të bordit me shumicën e thjeshtë të votave të fshehta;

b) Drejton veprimtarinë e bordit;

c) Drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të bordit;

d) Drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të bordit;

4. Kryetari i bordit shkarkohet me shumicë të thjeshtë të votave të fshehta të anëtarëve të bordit për moskryerje të detyrave të tij.

KREU 8
SEKRETARI I BORDIT

1. Mësuesi, anëtar i bordit, është sekretar i bordit.

2. Sekretari i bordit kryen këto detyra:

a) Përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhjet e bordit;

b) Mban shënimet e mbledhjeve të bordit;

c) Lajmëron anëtarët e bordit dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;

d) Mban arkivin e bordit në një mjedis të institucionit.

3. Minutat e mbledhjes së bordit, nëpërmjet sekretarit të tij, jo më vonë se 3 ditë mbas mbledhjes së tij, përcillen në njësinë arsimore vendore.

KREU 9
DREJTORI I INSTITUCIONIT DHE BORDI

Drejtori i institucionit ka për detyrë:

a) Të promovojë politikat për zhvillimin e standardeve profesionale në aspektet e sigurisë dhe shëndetit gjatë realizimit të procesit mësimor dhe jashtë tij në veprimtarinë komunitare.

b) T'i dorëzojë kryetarit të bordit kopje të urdhrave, udhëzimeve dhe rregulloreve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, të cilat i përkasin veprimtarisë së institucionit;

c) T'i raportojë bordit për çështje të mbarëvajtjes së shkollës, për të cilat kryetari i bordit i paraqet drejtorit kërkesë me shkrim;

d) T'i dorëzojë kryetarit të bordit një kopje të raportit të inspektimit, rezultatet e nxënësve të shkollës në provimet kombëtare dhe çdo studim që krahason institucionin me institucionet e tjera arsimore;

e) T'i sigurojë bordit një mjedis për zhvillimin e takimeve dhe për arkivin e tij.

KREU 10
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ky udhëzim është i zbatueshëm për institucionet e arsimit parauniversitar.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësisë arsimore vendore dhe institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat.

3. Udhëzimi nr. 27, datë 2.8.2013, "Për bordin e institucionit arsimor", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2018-1199, datë 5.7.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokol Korro, i datëlindjes 6.7.1970, në datën 24.12.1994, si dhe caktimin si kujdestare të posaçme të shtetasit të zhdukur, kërkuesen Rudina Raboci.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 532 lekë